

NEWSLETTER

Dhjetor



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

**Albsig Festë për
Fëmijët e Punonjësve
me Rastin e Festave
të Fundvitit**

**Dhurata, Udhëtime,
Çmime e Surpriza
në Festën e Fundvitit
në Albsig**

**Albsig Zgjedh
“Punonjesit e Vitit” 2022**

**Festo dhe Fito
Produkte të Sigurta
në Albsig**

**Albsig, në
Mbështetje të
Fëmijeve të
Policëve të Vrarë
në Krye të Detyrës**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP





ALBSIG FESTË PËR FËMIJËT E PUNONJËSVE ME RASTIN E FESTAVE TË FUNDVITIT

Fëmijët e punonjësve të Albsig u mbledhën për të kremtuar festat e fundvitit në ambientet e kompanisë. Një atmosferë fantastike u krijua nga spektakli i organizuar nga animatorët, ku nuk munguan edhe shumë dhurata për të vegjlit. Atmosfera festive, plot ngrohtësi, ku u mirëpritën vogëlushët dhe fëmijët e moshave të ndryshme, nis që nga kati i parë i godinës deri në zyrat e shoqërisë, për t'u stacionuar më pas në lokalin e përcaktuar për festë. Ndryshe nga vitet e tjera, fëmijët ishin kureshtarë të shikonin më nga afër postet e punës së prindërve. Me rastin e festave të fundvitit, Drejtori i Përgjithshëm i Albsig, z.Muharrem Bardhoci ka shtruar një koktejl për fëmijët e punonjësve duke i konsideruar ato si gjënë më të shtrenjtë në çdo familje. Duke mbajtur një fjalë përshëndetëse në këtë aktivitet, Z. Bardhoci i uroi përzierimisht Vitin e Ri 2023 atyre dhe të gjithë fëmijëve të vendit. "Paqe dhe begati sjellte për ju viti i ri. Këtë urim ua kushtoj fëmijëve, këtyre diejve, që na ngrohin zemrën çdo ditë, që na bëjnë të ecim përpara, të ngrihemi kur rrëzohemi e të buzëqeshim për ta! Të ardhmen ua kushtojmë atyre!", theksoi në urimin e tij z. Bardhoci. Në emër të Albsig, pjesë e Kastrati Grup u shpërndanë dhurata për fëmijët e moshave të ndryshme që vizituan ambientet e Albsig e më pas u stacionuan në lokalin e përzgjedhur për ta. Kjo nismë është konceptuar si një kartolinë urimi, për të bërë sa më të lumtur vogëlushët të vegjlit dhe do të vazhdojë edhe gjatë viteve në vazhdim. Një urim i veçantë shkoi për çdo fëmijë që vjen këtë muaj në jetë! Eventi me fëmijët e punonjësve të Albsig ishte ideuar në mënyrë të tillë që fëmijët të shikojnë më nga afër punën e prindërve dhe të mësojnë sadopak në fushën e sigurimeve. Kishte dhe nga ato fëmijë që me vjersha dhe këngë në një minikoncert të vogël të realizuar nga animatorët e festës falenderuan Albsig për eventin e realizuar.











FESTO DHE FITO PRODUKTE TË SIGURTA NË ALBSIG

Në Albsig, muaj Dhjetor është çdo ditë festë! Oferta pafund dhe ulje deri në 30%. Aktivitete për fëmijët gjatë gjithë muajit. Babagjyshi ju pret në Albsig me plot dhurata. Super paketa produktesh dhe shërbime me rastin e festave. Mos mungoni! Festat bëhen më të bukura me ALBSIG. Përfitoni nga shumëllojshmëria e SIGURIMEVE në ofertë gjatë kësaj periudhe. Në këtë sezon festash dhuroni vetes dhe familjes suaj dashuri dhe siguri vetëm nga Albsig! Nuk ke nevojë të nderësh makinën për të shkuar në zyrën më të afërt të Albsig. Ne kemi menduar për të gjithë ju. Hap celularin, Bli Online sigurimin dhe përfito ulje në produktet që ju duhen për të filluar sa më pozitivisht vitin e ri. Për drejtuesit e automjeteve që e kanë më shumë merak makinën e tyre, Albsig ka menduar 15% ulje për Sigurimin Kasko. Me këtë policë mund ta siguron automjetin tuaj nga çdo fatkeqësi e paparashikuar. Nëse keni lidhur kontratë mbi Sigurimin KASKO, Albsig ju garanton kompensimin e dëmit material të shkaktuar në automjetin tuaj në rastin e aksidentit në trafik edhe atëherë kur jeni ju që e keni shkaktuar aksidentin.



Albsig, përmes Policës së Sigurimit të Mjetit Motorik KASKO, ofron mbulimet në sigurim lidhur me humbjen ose dëmtimin e plotë ose të pjesshëm të mjetit motorik si rezultat i rreziqeve të ndryshme duke garantuar dëmshpërblim në kohë rekord dhe riparim në servise të specializuara. Ofertat nuk kanë të sosur. Lezetit të rehatisë së shtëpisë do t'ja shtojë më shumë Sigurimi i Banesës, Apartamentit ose Vilës suaj. Bli Online Sigurimin e Shtëpisë dhe fito 30% ulje në Sigurimin e Pronës suaj. Askush nuk mendon se do të preket nga një zjarr derisa të ndodhë. Edhe pse mund të keni ndërmarrë çdo hap për të siguruar biznesin apo shtëpinë tuaj, do të ishte e papërgjegjshme të mohoni mundësinë e aksidenteve nga zjarri. Qoftë një aksident në kuzhinë, tension i lartë elektrik, pajisje me defekt, zjarrvënie të qëllimshme, apo zjarre natyrore, është e domosdoshme të pajiseni me Policën e Sigurimit nga Zjarri për të zbutur pasojat e rënda që mund të kenë një forcë kaq shkatërrimtare. Specialistët tanë do t'ju ndihmojnë të vlerësoni siç duhet koston e vërtetë të një incidenti të tillë për çdo pronë tuajën të paluajtshme si dhe për përmbajtjen e saj, duke ju ofruar gjithashtu sigurim shtesë edhe për rreziqe të tjera që përbëjnë kërcënim në rrethanat në të cilat ndodheni. Ndërkaq pasuria do të jetë edhe më e sigurt kur do të ketë pronarë të shëndetshëm. Edhe për sigurimin e shëndetit Albsig ka menduar t'ju sjellë uljet e këtij viti. Bli Online Sigurimin e Shëndetit për vete dhe familjen tuaj dhe përfitonit 10% ulje në Sigurimin e Shëndetit në paketat e përzgjedhura nga gjithësecili prej nesh. Ndërkaq Albsig ka menduar dhe për aventurierët. Për ata që kanë menduar që festën e ndërrimit të viteve ta bëjnë jashtë Shqipërie, ku Albsig ka menduar 35% ulje për Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim.



DHURATA, UDHËTIME, ÇMIME E SURPRIZA NË FESTËN E FUNDVITIT NË ALBSIG



“Gëzojmë dhe festojmë së bashku” ky ka qenë dhe mesazhi që na ka shoqëruar këtë fundvit. Albsig feston bashkë me Kastrati Group. Tradita e fundvitit ka kulmuar me mbledhjen e të gjithë punonjësve të grupit në një mbrëmje gala pranë Hotel Continental Vorë. Në mbrëmje morën pjesë të gjitha bizneset e Grupit Kastrati dhe drejtuesit e tyre përmes një mesazhi përshëndetës të gjitha arritjet e vitit.

Viti 2022 tregoi pjekurinë tërësore të Albsig sh.a. pjesë e Kastrati Group, në një kohë ku ekonomia shqiptare ka pasur një nevojë të dukshme për mbështetje financiare. Sfida jonë më e madhe ishte rritja e Albsig në të gjithë parametrat e saj, rritje kjo e realizuar në mënyrë të tillë që të balanconte përgjegjësitë tona përballë të gjitha grupeve të interesit. ”

Kështu ka nisur mesazhin e urimit për të gjithë pjesëmarrësit në festën e fundvitit Drejtori i Përgjithshëm i Albsig z. Muharrem Bardhoci. Ndërkaq radhën e përshëndetjeve e ka vijuar Zv. Presidenti i Kastrati Group z. Leonard Kastrati, i cili përshëndeti stafin e Kastrati Group në të cilin përfshihet dhe Albsig sh.a. si një ndër bizneset më të suksesshme të grupit më të madh të biznesit në vend.

“Festat e fundvitit priten me emocione të mëdha sepsenormalisht zenë vendin e përjetimeve negative që mund të kemi kaluar dhe i hapin dritaren një rrezeje të re, drite pozitive. Urimi më i bukur për këto festa është që t’ia kalojmë bukur dhe të qëndrojmë gjithmonë të bashkuar pranë familjarëve e miqve tanë të dashur dhe të jemi sa më transparentë dhe korrekt me shërbimet tona ndaj klientëve. Shëndet dhe sa më shumë mbarësi, lumturi e begati. Kudo të mbizotërojë paqja, harmonia dhe dashuria. Gëzuar!!!

–përfundon mesazhin e tij z. Kastrati.

Festat e fundvitit janë cilësuar si sezoni më kulmant për çdo punonjës. Jo vetëm kaq, por kjo periudhë shikohet si “dritë jeshile” për çdonjërin nga ne. Qëllimi i këtij eventi ishte për të festuar arritjet e vitit 2022 dhe për të shpalosur direktivat për vitin 2023. Normalisht, kur flasim për festat e fundvitit i referohemi Krishtlindjes dhe Vitit të Ri, dy festa të bukura me të cilat ne mbyllim një vit dhe presim ardhjen e një viti të ri. Si Krishtlindja edhe Viti i Ri janë dy festa shumë të bukura dhe madhështore që festohen nga njerëzit në mënyra të ndryshme, por që kurrë nuk kalohen në heshtje. Çdo njeri i feston në mënyra nga më të ndryshme, por e rëndësishme është që këto festa janë shumë të bukura dhe priten me gëzim nga njerëzit në mbarë botën. Festat e fundvitit janë festa që kënaqin plot njerëz edhe nëse ky vit që lamë pas nuk ka qenë shumë i mirë për shumë njerëz, mendohet që viti tjetër të jetë më i mbarë dhe me ëndrra dhe dëshira të tjera, që edhe pse nuk u plotësuar nga viti që lamë pas, pse jo të plotësohen në këtë vit të ri. Në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig festa e fundvitit bën të mundur gërshetimin e tradicionales me modernen. Punonjësit janë ata që ndjejnë më shumë atmosferën e ngrohtë të festave dhe mbështetjen e drejtuesve të shoqërisë në evente të tilla sociale. Tashmë është bërë traditë e përvitshme që përveç pagës së 13-të, Albsig ndan dhurata dhe çmime speciale për punonjësit sipas performancës që ata kanë shpalosur në punë përgjatë një viti kalendarik të lënë pas. Fundviti është përherë sezoni që pritet me shumë entuziazëm nga të gjithë punonjësit sepse gjithësecili prej tyre është i predispozuar të ketë një performancë sa më të lartë në punë dhe të mund të shpërblehet për punën dhe përkushtimin që shfaq.



ALBSIG ZGJEDH

“PUNONJESIT E VITIT” 2022

Si çdo fundvit festa madhështore e Albsig, pjesë e Kastrati Grup u zhvillua pranë Continental Hotel në Vorë. Punonjësit Albsig kaluan një nga mbrëmjet më të bukura përmblylëse të këtij viti. Një madhështi e veçantë një spektakël i organizuar me delikatesë, bëri që stafet pjesëmarrëse të Grupit Kastrati të kalonin një mbrëmje të paharrueshme. Mes këngëtarëve profesionistë, muzikës, lojrave, shorteve dhe argëtimit, stafet e Kastrati Grup përjetuan një nga mbrëmjet më të veçanta në përmblyllje të punës për vitin që po lemë pas. Nuk munguan as çmimet dhe trofetë për vitin 2022. Ata që kanë kontribuar për të bërë ndryshimin në ecurinë dhe sukseset që ka shënuar Shoqëria e Sigurimeve Albsig gjatë vitit 2022. Sipari i çmimeve ka nisur me agjentin më të mirë të vitit 2022 ku çmimin e mori agjenti i qytetit të Vlorës, Sergej Koçaj. Me një përkushtim dhe vëmendshmëri arriti të spikasi në punën e tij si agjenti më i mirë në të gjithë rrjetin e shitjeve të Albsig.

Piro Halili

**-Dega “Adem Jashari”,
dega më e mirë në total
dhe në raport me
produktet vullnetare**



Ndërkaq stafeta e më të mirëve u pasua edhe te drejtorët e Albsig. Redi Ujkashi – Drejtorja e Sigurimeve në bashkëpunim me Bankat, dhe Klodian Gjonaj – Drejtorja e Sigurimeve Kasko dhe GPS, ishin dy drejtorët e drejtorive të Albsig që spikatën në menaxhimin dhe përkushtimin e tyre në punë për vitin 2022. Rugëtimi i suksesit vazhdon sërish te drejtorët e Albsig.



Redi Ujkashi & Klodian Gjonaj

**-Drejtoritë më të mira
për vitin 2022**



E veçanta që spikati, jo vetëm nga drejtimi i mbajtur prej tij, por nga direktivat që janë realizuar, ishte dhe Dega e Albsig "Adem Jasharri" drejtuar nga z. Piro Halili, ku spikati si dega më e mirë në total dhe në raport me produktet vullnetare. Ndër të tjera, në këtë rrugëtim suksesi nuk mund të lihej pa përmendur Departamentin e Financave, një ndër departamentet më të rëndësishme për Albsig ku këtë vit spikati për punën dhe përkushtimin e tij të palodhur z. Nik Marku. Ndërkaq, departamenti që tashmë është kryefjala e Albsig, është Departamenti i Dëmeve, që për këtë vit u përfaqësua me Gramos Vishën. Ndërkaq në këtë kalvar çmimesh duke përzgjedhur më të përkushtuarit në punë nuk mund të mungonte Albsig Jetë. Edhe pse një Shoqëri Sigurimi Jete e re në treg, por shumë e suksesshme. Kjo e fundit e ngritur mbi një staf profesionistësh, këtë vit ka përzgjedhur Endrit Abazi, si një ndër punonjësit më të përkushtuar, jo vetëm në Departamentin e Shitjeve ku ai punon, por në të gjithë shoqërinë që ai përfaqëson.

Endrit Abazi

**-Punonjësi i Vitit
për Albsig Jetë**



Gramos Vishaj

**-Punonjësi më i mirë
në Departamentin
e Dëmeve**



Stafi Albsig Përzgjedh më të Mirin për Vitin 2022

Rrugëtimi i më të mirëve për vitin 2022 nuk kishte të sosur në Albsig. Transparenca është metoda e cila është përdorur për të nxjerrë në pah më të mirët në çdo fushë. Ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit Stafi i Albsig përmes një votimi online ka bërë të mundur përzgjedhjen e punonjësit më të mirë për ta. Votimi për punonjësin më të mirë të përzgjedhur nga stafi ka zgjatur më shumë se dy ditë dhe përmes votimeve online është përzgjedhur dhe më i votuari për 2022. Ervis Shima, inxhinieri i IT, përfaqësues i Drejtorisë së IT, është përzgjedhur punonjësi më i mirë dhe më i votuari nga stafi i Albsig. Kanë qenë votat e shumta të stafit të Albsig që kanë nxjerrë në pah inxhinierin e përkushtuar të IT-së. Urojmë që tradita të vazhdojë dhe në vitet e tjera. Gjithashtu urojmë që gjithmonë të dali në pah më i miri në të gjitha fushat.





**Med-Kartë, Karta Juaj e Shëndetit FALAS
me Blerjen Online të një police sigurimi!**



ALBSIG, NË MBËSHTETJE TË FËMIJEVE TË POLICËVE TË VRARË NË KRYE TË DETYRËS

Një shoqëri miqësore me fëmijët është ajo që nxit të drejtat e fëmijëve dhe bën të mundur që zëri i tyre të dëgjohet më shumë në vendimet që i prekin ata. Ajo i krijon hapësira gjithëpërfshirëse ku fëmijët luajnë, janë të shëndetshëm, të mbrojtur, të arsimuar, të padiskriminuar dhe gëzojnë një mjedis koheziv dhe të pasur në aspektin kulturor. Dhe kur bëhet fjalë për një target grupi fëmijësh më të veçantë siç janë fëmijët e policëve të vrarë në krye të detyrës, përkushtimi nga shtetet, biznesi dhe shoqëria civile në përgjegjësi është më i veçantë. Me rastin e festave të fundvitit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, organizoi një aktivitet festiv për fëmijët dhe familjarët e punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës. Në evenimentin e organizuar për fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës morën pjesë drejtuesit e policisë së shtetit, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe përfaqësues të bizneseve të ndryshme etj. Si mbështetëse e nismës së tillë humanitare ishte dhe Shoqëria Albsig sh.a. pjesë e Kastrati Group. Nën atmosferën festive të krijuar u bë dhe shpërndarja e pakove me dhurata të ofruara nga kompani dhe organizata për familjarët dhe fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës. Po ashtu për 40 fëmijë të policëve të vrarë 1 deri në 18 vjeç u shpërndanë pajisje elektronike si iPad, telefona dhe PC.



☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL